



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 8698/30 / Prot.

Divjakë më 27 / 08 / 2025

RAPORT VENDIMMARRJE

I KOMISIONIT TË BUJQËSISË, PYJEVE, MBROJTJES SË MJEDISIT

Komisioni i Shërbimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi **Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Divjakë**, duke marrë në konsideratë rëndësinë e tij për zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Baza Ligjore- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të **mbetjeve**” dhe **ndryshimet e tij**;- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 25.05.2016, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2016–2030”;- Udhëzimet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve.

Rëndësia e Planit

Plani local i Menaxhimit të integruar të Mbetjeve Urbane për Bashkinë Divjakë, 2025-2029, përbën një dokument strategjik, që synon:- Të përmirësojë sistemin e grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve;- Të reduktojë ndotjen mjedisore dhe të mbrojë shëndetin publik;- Të nxisë riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve;- Të harmonizojë praktikat vendore me objektivat kombëtare dhe direktivat e BE-së;- Të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit dhe përfshirjen e tij në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve

Përfundime dhe RekomandimeKomisioni i Shërbimeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, konstaton se Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane është një instrument i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë Divjakë. Ky plan do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve publike, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve.

Në këtë kuadër, pas diskutimeve të hapura në degjese publike, Komisioni i Bujqësisë, pyjeve, mbrojtjes së mjedisit i propozon Këshillit Bashkiak Divjakë miratimin në tërësi të **Planit lokal të Menaxhimit të integruar të mbetjeve 2025-2029**.

KOMISIONI I BUJQËSISË, PYJEVE, MBROJTJES SË MJEDISIT

1. Shpëtim Sheshi (kryetar)

2. Ardjan Shurdhaqi (zv.kryetar)

3. Njazi Balla (sekretar)

4. Ajete Mebelli (anëtar)

5. Seit Kajo (anëtar)

6. Mishel Verdha (anëtar)

7. Lili Biti (anëtar)

